



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

VENDIM NR 142 Datë 04.11.2020

**Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të PBA 2021-2023 për
Bashkinë Dibër**

Mbështetur në nenin 9 pika 1.3, nenin 34, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, nenin 34 të ligjit nr.68/2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”i ndryshuar, udhëzimi Plotësues i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, nr.27 datë 10.07.2020, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023” Këshilli Bashkisë, në mbledhjen e tij, vendosi me datë 04.11.2020 me 17 vota pro 1 vota kundër 1 vota apstenim.

VENDOSI :

1. Miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm për vitet 2021 - 2023, të Bashkisë së Diber, sipas tabelës (D1) tavanet e PBA 2021-2023, pjesë përbërese e Instrumentit të Planifikimit Financiar (FPT).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Dibër.

Kryetar Këshilli

Sokol SAVA



Adresa: Bulevardi “ELEZ ISUFI”, Peshkopi, [email:bashkiadiber@gmail.com](mailto:bashkiadiber@gmail.com) nr.tel:0035521822935